

## Tabela e re e zhvillimit të leximit

### Faza e parë: Shqyrtimi

Fëmija zhvillon vazhdimisht aftësinë e leximit në tekste që përmbajnë pak fjalë në secilën faqe, në të shumtën e rasteve me figura që pasqyrojnë tekstin. Leximi që bën fëmija në kërkim të përmbajtjes/domethënies së tekstit kërkon energji të madhe dhe vëmendje. Fëmija, duke filluar nga pika 11, përdor strategjitë e leximit dhe përforcon tani aftësinë e tij të leximit me tekste më të gjata dhe me më pak figura. Leximi mekanik tashmë e ka humbur rëndësinë e tij.

1. "Lexon" (gjen) dhe shkruan (pasqyron) emrin e tij.
2. Njeh drejtimin e fjalëve në fjali (nga e majta në të djathtë).
3. Tregon se e ka zbuluar se fjalët e shkruara "mund të thuhet"
4. Lexon fjalë të njohura në tekste të ndryshme duke i parë fjalët si figura.
5. Lexon fjalë të panjohura me ndihmën e fjalëve që fëmija tashmë njeh.
6. Ndhimohet nga shkronjat (p sh shkronja e parë) për të dalluar fjalë në text. Nganjëherë korrigjon vetveten.
7. Kur paraqitet nevoja, gjatë leximit, merr ndihmë efektive nga shkronjat. Vetkorrigjimi është i zakonshëm.
8. Është në gjendje ta kthej një rrethanë nga e folur-dëgjim në shkrim-lexim.
9. Gjen ndihmë efektive tek tingujt për të lexuar fjalë të gjata, të panjohura.
10. Përdor dhe kombinon disa nga strategjitë\* e sipërpërmendura për një lexim sa më funksional të teksteve të thjeshta.  
\*(Shembuj për strategjitë: fjala si figurë (p 4), gjejnë fjalë të reja me ndihmën e fjalëve që tashmë i njohin (p 5), ndihmohen nga shkronjat (p 6), ndihmohen nga tingujt (p 9).
11. Lexon me vështirësi tekste më të gjata se më parë dhe kërkon të mbërrijë tek përmbajtja, me qënë se fëmija dëshiron të kuptojë tekstin.
12. Para se të ngecë, lexon të paktën 3-4 fjalë rresht në libra (tekste) që bëjnë fjalë për sende që fëmija i njeh.

### Faza e dytë: Zgjerimi

Fëmija ka tashmë një bazë me strategji leximi dhe e zgjeron fushën e tij të leximit me libra gjithmonë e më të gjata, libra në të cilat teksti nuk ilustron me figura. Në tre raste gjatë kësaj faze, kur fëmija është në gjendje të lexojë rrjedhshëm, paraqiten funksione të reja leximi: funksioni i kërkimit, i vënies në zbatim si dhe ai i vështrimit të tekstit në tërësi.

13. Leximi është më i rrjedhshëm, ngec vetëm nganjëherë.
14. Lexon dhe kërkon njëkohësisht, d m th gjen shpejt të dhëna të veçanta në një tekst.

15. Lexon rrjedhshëm, pa pengesë dhe kupton mirë. Preferon të lexojë në heshtje.
16. Lexon dhe kupton një instruksion ose përshkrimin e një procesi pune që paraqitet në disa shkallë, p sh një recetë. Njëkohësisht, tregon nëpërmjet veprimeve të tij se e ka kuptuar përshkrimin.
17. Kupton përmbajtjen e filmave të huaj dhe programeve për natyrën duke lexuar tekstin në ekran.
18. Lexon shumë – e përpin tekstin.
- 18 a Lexon me sukses një seri librash pa figura shpjeguese, ku ngjarja zhvillohet pa komplikacione, d m th lexim klasik i librit.
- 18 b Lexon me lehtësi libra, kryesisht letërsi për të rinj, me përshkrim personazhesh, përshkrim të ambjentit dhe monologje të brendshme; kërkon të kuptojë më shumë se sa vetëm ngjarjen.
- 18 c E zgjeron zonën e tij të leximit me gjini të ndryshme letrarare të letërsisë për të rritur, lexon nganjëherë disa libra paralel; lexon dhe gjen dimensione më të thella.
19. Thellohet dhe shikon tërësinë, d m th është në gjendje që pasi të jetë thelluar në një tekst voluminoz, në një rrethanë të mëvonshme të gjejë shpejt pikat kryesore të përmbajtjes së tekstit dhe të strukturës së tij.

### **FAZA 3 –Leximi i literatures /letrar i vetëdijshëm/**

Me lexim letrar të vetëdijshëm nënkuptohet ai lexim që supozon të menduarit abstrakt dhe hipotetik. Kjo do të thotë që lexuesi mund t'i kuptojë principet të cilat nuk i përgjigjen një formulimi të rregullt në tekst dhe gjithashtu kupton rezonimin hipotetik, d.m.th. mund të nxjerrë përfundime për dukuri jashtë përvojës së vet konkrete. Ky lloj leximi hap mundësinë që në mënyrë të pavarur lexuesi të depërtojë brenda përmbajtjes dhe përmes prozës dhe teksteve të letërsisë artistike të gjinive të ndryshme letrare, gradualisht të kuptojë domethënien e metaforave dhe dimensionet e reja të niveleve të ndryshme.

#### **L. Leximi i literatures /letrar i vetëdijshëm/**

Duhet cekur se kjo rezyme nuk është e mjaftueshme në mënyrë që nxënësi të mund të nivelizohet në bazë të tabelës së re të të lexuarit ( LUS-it). Që të arrihet niveli i kuptueshmërisë në vlerësimin dhe vendosjen e nxënësit në nivel të merituar, duhet shfrytëzuar këto libra : "Nya lusboken", "Komplement till Nya lusboken", në konsultim me kriteret e shkollës.

Si ndihmë për punë më të suksesshme mund të shfrytëzohen edhe dy videofilma dhe një CD /në Internet adresa [www.lus.nu/](http://www.lus.nu/)

Ndihmat tjera teknike lidhur me këtë rezyme janë Excel – mallar, diagrami i protokolit dhe informatat në faqën e internetit [www.bibo.se](http://www.bibo.se)

Përkthyen në gjuhën shqipe

Nasuf Xhemajli  
Edlira Albrup